

1. Qellimi dhe Objektivat e Politikave te Kontabilitetit

Qellimi i kësaj politike është që të reflektoje parimet baze që të mundësojnë Kontabilitetin në dhënien e një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjithë aspektet materiale, të pozicionit dhe rezultatit financiar të Bankes në përputhje me Standartet Nderkombetare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Shenim: Persa i perket raportimit për qellimet e Bankes së Shqipërisë (“BSH”) Banka përfaqëson pasqyrat financiare në përputhje me Nenin 47 të Ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr. 9662, 18 dhjetor 2006).

Objektivi kryesor i kësaj politike është që të garantojë se:

- Në praktikën e saj kontabel, Banka ndjek SNRF.
- Banka, përdor të njëjtat politika kontabiliteti, metoda vlerësimi dhe standarte raportimi nga njëra periudhë në tjetrën. Cdo ndryshim eventual i ndonjë politike kontabiliteti në mes të periudhës do t’i raportohet Keshilli Drejtues dhe do të shoqërohet me nota përkatëse në Raportin Vjetor.
- Banka paraqet në mënyrë besnike informacion të plotë lidhur me gjithë transaksionet domethënëse apo ngjarje të tjera duke ndjekur një sërë parimesh, parime të cilat do të perditohen me ndryshimin e SNRF-se.

2. Parimet Themelore te Ndertimit te Pasqyrave Financiare

Duke patur parasysh objektivat e lartpërmendura, politikën e kontabilitetit dhe raportimit të Bankes janë të mbështetura në supozimet dhe parimet e mëposhtme:

2.1 Supozimet baze te pergatitjes se pasqyrave financiare

Vijimësisë

Që do të thotë se veprimtaria ekonomike e bankes do të ketë vijimësi dhe ajo nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj.

Parimi i te drejtave te konstatuara (accrual basis)

Që do të thotë se efektet e transaksioneve apo eventeve njihen kur ndodhin (dhe jo kur paraja është paguar apo marre) dhe se ato regjistrohen në librat kontabel dhe raportohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën ndodhin.

2.2 Parimet baze te pergatitjes se pasqyrave financiare

2.2.1 Parimi i kuptueshmërisë

Informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe i kuptueshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare.

2.2.2 Parimi i relevances

Informacioni duhet te jete relevant per vendimmarrjen e perdoruesve. Informacioni e ka cilesine e te qenit relevant kur influencon vendimmarrjen e perdoruesve duke i ndihmuar ata ne vleresimin e eventeve ne te kaluaren, te tashmen apo te ardhmen apo ne korrektimin e vleresimeve te bera ne te kaluaren. Relevanca e informacionit ndikohet nga (a) natyra e tij dhe (b) materialiteti.

Materialiteti

Informacioni në këto pasqyra konsiderohet material nëse mungesa ose pasaktësia në prezantimin e tij do të ndikonte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. Në përcaktimin e materialitetit duhet të merren parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit. Për transaksione të caktuara, mund të ndodhë që shumat e vogla mund të kenë një rëndësi kuptimore më të madhe për përdoruesit se sa transaksione të tjera të zakonshme.

2.2.3 Parimi i besueshmërisë

Informacioni mbart cilësinë e besueshmërisë kur ai është i paanshëm dhe nuk përmban gabime materiale, si dhe kur përdoruesit mbështeten mbi të duke pasur besim që ky informacion është një prezantim besnik i asaj që ky informacion përpiqet ose pritët në mënyrë të arsyeshme të prezantojë dmth të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera.

Përmbajtja në raport me formën

Për regjistrimin e transaksioneve të bankes nuk kihet parasysh vetëm baza ligjore mbi të cilën ato janë formuluar ose krijuar por edhe përmbajtja e tyre ekonomike e cila është e një rëndësie primare.

Maturia (i kujdesit)

Prudencia është një shkallë kujdesi në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme gjatë berjes së parashikimeve/vleresimeve që kerkohen në kushte të pasigurisë. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten me maturi dhe kujdes me qëllim që të shmangët mbivlerësimi i aktiveve dhe i të ardhurave ose nënvlerësimi i detyrimeve dhe i shpenzimeve.

Në të njëjtën kohë, nënvlerësimi i qëllimshëm i aktiveve dhe i të ardhurave si dhe mbivlerësimi i qëllimshëm i detyrimeve dhe shpenzimeve, sikurse edhe krijimi i rezervave të fshehura nga përdoruesit e pasqyrave financiare, nuk justifikohet.

Neutraliteti

Informacioni duhet të jete i lire nga paragjykimet. Pasqyrat financiare nuk jane neutrale kur nga menyra e prezantimit te informacionit ato ndikojne ne vendimmarrje apo gjykimeve me qellim arritjen e nje rezultati te paracaktuar.

Plotesia

Qe te jete i besueshem informacioni duhet te jete i plote brenda kufijve te materialitetit dhe koston.

2.2.4 Parimi i krahasueshmërisë

Për përgatitjen e pasqyrave financiare duhet të përdoren vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formate të pasqyrave financiare (politika dhe forma që do të amendohen me amendimin/ndryshimin apo standardet e reja).

Qëndrueshmëria në politikën kontabël, paraqitja në formatin e pasqyrave financiare është e nevojshme për një krahasim objektiv të treguesve të performancës financiare bankes raportuese në vite. Kërkesat standarde për politikën kontabël, formatet e paraqitjes së informacionit financiar si dhe informacionin që duhet paraqitur në pasqyrat financiare përbëjnë bazën për krahasimin e të dhënave financiare të njëjësive të ndryshme raportuese.

3. Baza e Pergatitjes se Pasqyrave Financiare¹

3.1 Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat financiare te Bankes jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet ne fuqi te Bordit te Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

3.2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike perveç:

- instrumentat financiare te matura me vleren e tregut nepermjet fitim humbjes qe vleresohen mbi bazen e vleres se tregut
- letrave me vlere te disponueshme per shitje qe vleresohen mbi bazen e vleres se tregut.

3.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke Shqiptar (LEK), e cila eshte edhe monedha funksionale e Bankes. Pervec rasteve kur specifikohet ndryshe, informacioni financiar eshte paraqitur ne LEK dhe eshte i rrumbullakosur ne mijeshen me te afert.

3.4 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe Drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth aplikimit te politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te prithshme.

Ne vecanti, informacioni rreth burimeve kryesore te pasigurise se vleresimeve dhe gjykimeve kontabel aplikimin e politikave kontabel te Bankes, qe kane efekt te rendesishem ne shumate e njohura ne pasqyrat financiare jane pershkruar ne seksionin 5 te kesaj politike.

¹ Permbledhja e parimeve SNRF te aplikueshme per Banken. Cdo standard SNRF eshte i aplikueshem per Banken.

4. Permbledhje e Parimeve Kryesore Kontabel²

Politikat e kontabilitetit të Bankës janë aplikuar në mënyrë konsistente gjatë gjithë periudhës të raportimit të paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhe të huaj janë regjistruar me kursin e këmbimit të ditës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhe të huaj janë këmbyer me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit janë njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe të huaj mbahen me kosto historike në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit.

4.2 Instrumentat financiarë

Klasifikimi

Huata dhe Llogaritë e Arketueshme përbehen nga huata dhe paradheniet ndaj klientëve, institucioneve financiare dhe hua punonjësve.

Aktivët e mbajtura deri në maturim janë mjete financiare me pagesa fikse dhe maturim të përcaktuar, për të cilat Banka ka për qëllim dhe mundësi t'i mbaje deri në maturim.

Njohja

Aktivët e mbajtura në maturim, huata dhe llogaritë e arketueshme regjistrohen në ditën kur Banka disburson vlerën monetare të tyre.

Matja

Instrumentat Financiarë maten me koston fillestare, duke përfshirë dhe kostot e transaksionit. Të gjitha kreditet e disbursuara, llogaritë e arketueshme si dhe aktivët e mbajtura në maturim maten me koston e amortizuar minus humbjen nga zhvleresimet në qoftë se ka. Kosto e amortizuar llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Primet dhe zbritjet, bashkë me kostot fillestare të transaksionit, janë të përfshira në vlerat e mbajtura të instrumentave perkatese dhe amortizohen duke u bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, atëherë kur është e zbatueshme.

Instrumenta të vecanta

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përbehen nga balancat e parave në arke, ato të depozituara në Bankën Qendrore si dhe investimet likuide afatshkurtra me afat maturimi tre-mujor ose më pak.

Bonot e thesarit të mbajtura në maturim

Bonot e Thesarit konsiderohen si investime të mbajtura deri në maturitet përse kohe që Banka ka qëllimin dhe mundësinë ta bejë këtë.

² Shenim: Politikat e detajuara janë një përmbledhje e politikave kryesore, për më shumë banka aplikojnë të gjithë politikat e reflektuara në SNFR.

Letrat me vlere te investimit te mbajtura ne maturim

Investimet e letrave me vlere te mbajtura ne maturim jane investime hua te cilat Banka ka qellimin dhe mundesine t'i mbaje deri ne maturitet. Si rezultat ato klasifikohen si aktive te mbajtura ne maturim.

Bonot e thesarit dhe letrat me vlere te vlefshme per shitje.

Ketu hyjne letrat me vlere te cilat Banka nuk ka si synim ti mbaje deri ne maturim. Ato mbahen per nje periudhe kohe te papercaktuar Ne qofte se .Banka ne pergjigjete nevojave per likuditet shet nga portofoli i letrave me vlere te mbajtura per maturim, atehere i gjithë portofoli ekzistues klasifikohet ne grupin te vlefshme per shitje. Banka mbeshtetur ne IAS 39 eshte e detyruar qe te gjithë portofolin e letrave me vlere ta mbaje ne kete klasifikim per 2 vjet rrjesht. Vetem pas dy vjeteve (n.q.se nuk ka shitur nga ky portofol) Banka ka te drejte ti klasifikoj .

Huate dhe paradheniet dhene klienteve dhe institucioneve financiare

Huate dhe paradheniet e leshuara nga Banka klasifikohen si hua dhe llogari te arketueshme te leshuara. Huate ose kredite raportohen per vlere neto duke zbritur provigjonet per zhdemtimin e kredive ne menyre qe te reflektohen shumat e rikuperueshme.

Mosnjohja

Mosnjohja e nje mjete financiar te aktivitet ndodh atehere kur Banka e humb kontrollin mbi te drejten kontraktuale qe perben kete mjet. Kjo ndodh ne momentin kur keto te drejta jane permbushur, kane skaduar ose jane dorezuar. Mosnjohja e nje detyrimi financiar ndodh kur ky pushon se qeni i tille. Banka perdor metoda specifike identifikimi per te percaktuar nese ka realizuar fitim apo humbje nga mosnjohja. Mosnjohja e huave dhe llogarive te arketueshme behet atehere kur Bankes i paguhet huaja.

Zhvleresimi dhe mosarketimi i aktiveve financiare

Ne cdo date te pergatitjes se pasqyrave financiare behet vleresimi per te percaktuar nese ekziston evidence e mjaftueshme qe nje mjet financiar ose grup mjeteesh te mund te jete zhvleresuar. Ne qofte se ka nje evidence te tille, percaktohet vlera e arketueshme dhe shuma e zhvleresimit bazuar ne vleren neto aktuale te pagesave te pritshme ne te ardhmen, si dhe behet njohja e diferences midis shumës se arketueshme dhe balances se mbetur si vijon.

Ne cdo date te pergatitjes se pasqyrave financiare Banka vlereson nese ekziston evidence e mjaftueshme qe nje mjet financiar ose grup mjeteesh eshte zhvleresuar. Nje aktiv financiar apo nje grup i tille eshte zhvleresuar vetem nese ekziston nje evidence objektive zhvleresimi si nje rezultat i nje apo disa ngjarjeve te ndodhura pas njohjes fillestare te aktivitet, dhe kjo (keto) ngjarje ka nje impakt ne flukset e pritshme te te ardhurave per kete aktiv apo grup aktivesh fianaciare te cilat mund te vleresohen me besueshmeri.

Kriteret qe Banka perdor per te percaktuar nese ekziston evidence objektive zhvleresimi perfshijne:

- Vonesat ne pagesat kontraktuale te principalit dhe te interesit;
- Veshitimi i hasura nga huamarresi ne flukset e mjeteve monetare;
- Mosrespektim i kushteve te kontrates se kredise;
- Fillimi i procedurave te falimentimit

- Perkeqesim i pozites konkurruese te huamarresit
- Perkeqesim ne vleren e kolateralit

Banka se pari kontrollon nese ekziston nje evidence objektive zhvleresimi per aktivet financiare qe jane individualisht te konsiderueshem. Nese Banka ve re se nuk ka nje evidence objektive zhvleresimi per aktivet financiare te kontrolluara individualisht per zhvleresim, pavaresisht nga fakti nese jane te konsiderueshem (ne vlere) ose jo, i perfshin ato ne grupin e aktiveve me karakteristika rreziku te ngjashme me to dhe, po ne grup, i vlereson ato per zhvleresim. Aktivet qe jane testuar per zhvleresim individual dhe per te eshte njohur nje humbje nga ky zhvleresim, nuk perfshihen ne nje vleresim grupi per zhvleresim.

Vlera e zhvleresimit percaktohet si diference midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te pagesave te pritshme ne te ardhmen skontuar me normen fillestare te interesit efektiv. Llogaritja e vleres aktuale te pagesave te pritshme te aktiveve financiare te kolateralizuara reflekton pagesat e pritshme qe mund te rezultojne nga ekzekutimi i kolateralit pakesuar me kostot e shitjes se kolateralit. Per qellime te nje vleresimi ne grup per zhvleresim, aktivet financiare grupohen ne baze te karakteristikave te ngjashme te rrezikut te kredise (lloji dhe vlera e kredise). Banka ben perlllogaritjet per te identifikuar humbjet e vleresuara te pritshme te kredise ne cdo grup. Performanca e portofolit analizohet per disa muaj per te arritur ne nje faktor mesatar humbjeje, i cili me pas do te zbatohet per te vleresuar zhvleresimin per cdo grup.

Kur nje kredi vleresohet si e pa-mbledhshme, ajo crregjistrohet kundrejt provigjionit perkates te percaktuar per zhvleresimin e kredise. Hua te tilla fshihen pasi jane ndermarre dhe kryer te gjitha procedurat e nevojshme dhe jane percaktuar shumat e humbjes, si dhe duke u mbeshtetur ne vendimin e Bordit drejtues te Bankes per nxjerjen e kredive jashte bilanci. Rikuperimet te cilat pasojne shumat qe jane fshire paraprakisht kreditohen ne Pasqyren e Fitim Humbjes tek zeri "Shlyerje te huave te fshira nga bilanci".

Ne qofte se, ne nje periudhe te mevonshme, shumat per provigjione per zhvleresimin e kredive ulen dhe kjo ulje mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje qe ndodh pasi zhvleresimi ishte rregjistruar (si permiresim i gjendjes se kredimarresit), clirimi i provigjioneve rregjistrohet si kreditim te provigjioneve per zhvleresim kredish ne pasqyren permbledhese te te ardhurave.

Per Aktive financiare te mbajtura deri ne maturim – vlera kontabel e ketyre aktiveve zvogelohet me shumat e vleresuara te rikuperueshme si ne menyre te drejteperdrejte apo nepermjet nje llogarie provigjioni, dhe vlera e humbjes do te perfshihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave.

4.3 Marreveshjet e riblerjes

Kur instrumentet e borxhit jane shitur nen nje premtim riblerje me nje cmim te paravendosur, ato qendrojne ne bilanc dhe vlera monetare e marre regjistrohet nen zerin "Hua dhe paradhenie nga institucionet financiare". Ne anen tjetere, instrumentet e borxhit qe jane blere nen premtimin per t'i rishitur nuk njihen ne bilanc dhe vlera monetare e paguar eshte regjistruar nen "Hua dhe paradhenie dhene institucioneve financiare".

4.4 Aktive te qendrueshme te patrupezuara

Aktivitet e patrupezuara te blera nga Banka shprehen me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar. Programet kompjuterike amortizohen sipas metodese se vleres se mbetur me norme

vjetore amortizimi 25%. Aktive te tjera patrupezuara amortizohen sipas metodes lineare me norme vjetore amortizimi 15%.

4.5 Aktive te qendrueshme te trupezuara

Aktivitet e qendrueshme te trupezuar jane te shprehura me kosto duke i zbritur zhvleresimin e akumuluar. Zhvleresimi i vitit eshte llogaritur sipas metodes se vleres se mbetur ne perputhje me normat e meposhtme:

	Normat vjetore
Paisje kompjuterike	25%
Paisje zyre	20%
Paisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

4.6 Aktivet afatgjata te mbajtura per shitje

Aktivitet afatgjata dhe grupet e nxjerra jashte perdorimit klasifikohen si te mbajtura per shitje nese vlere e tyre kontabel neto do te rifitohet parimisht nepermjet nje transaksioni shitjeje ne vend te perdorimit te vazhdueshem. Ky kusht konsiderohet i plotesuar nese shitja e aktivitet eshte me probabilitet te larte dhe eshte i pershtatshem per shitje te menjehershme ne kushtet e tij aktuale. Drejtimi i Bankes duhet te jete i angazhuar ne nje plan per te shitur aktivin, i cili pritet qe te kualifikohet si shitje e perfunduar brenda nje viti nga data e klasifikimit. Gjithsesi aktivitet vazhdon te mbahet per shitje edhe pas nje viti kur a) vonesa ne shitje ka ndodhur nga rrethana qe jane pertej kontrollit te Bankes dhe b) ka evidenca te mjaftueshme qe Banka mbetet e angazhuar tek planet e saj per te shitue asetin

Aktivitet afatgjata te mbajtura per shitje maten me vleren me te ulet mes vleres se tyre kontabel neto dhe vleres se drejte minus kostot per shitje.

4.7Aktive afatgjate materiale te investuar,

Mbeshtetur ne IAS 40, Bankes I lind e drejta ti klasifikoj ne kete grup kur;

- Mbahen per te siguruar te ardhura nga qeraja.
- I klasifikon dhe I mban ne kete grup kur Banka ka si qellim dhe rritjen e vleres se tyre, duke I mbajtur per periudha afatgjate dhe jo per qellime shitje afatshkurtera.

Ne zbatim te IAS 40 ne kete klasifikim hyjne;

- Toka e mbajtur per rritjen e vleres se kapitalit per periudha afatgjata dhe jo per qellime shitje afatshkurtera ne rrjedhen normale te biznesit.
- Toka e mbajtur per perdorim ne nje te ardhme aktualisht te papercaktuar.ne kete rast ne qoftese Banka nuk e ka percaktuar se do ta perdore token si prone te saj,ose per shitje afatshkurter,atehere toka trajtohet si e mbajtur per rritjen e vleres se kapitalit.

- Nje ndertese e zoteruar nga njesia ekonomike ose eshte e lire dhe mbahet per tu dhene per nje ose me shume qera te zakonshme.

Keto aktive duhet te vleresohen me vleren e tregut para mbylljes se pasqyrave financiare dhe diferenca midis vleres se tregut dhe vleres ne kontabilitet kalon ne rezultatin e bankes..

Trajtimi sipas IAS 16 Mjetet e Trupezuara. Ketu hyjne te gjitha mjetet e trupezuara te cilat jane prone e Bankes.

Aktivitet e mesiperme do te trajtohen sipas ketij standarti, ne qoftese ato do te vihen ne perdorim nga ana e Bankes.

4.8. Depozitat, Borxhi I varur

Depozitat, llogarite rrjedhes dhe borxhi I varur jane burimet kryesore te financimit. Ato mbahen me vleren e tyre te drejte.

4.9 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat dhe shpenzimet per interesa per te gjitha instrumentat qe mbartin interes, jane njohur ne pasqyren e te ardhurave sipas parimit te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e normes efektive te interesit. Te ardhurat nga interesat perfshijne dhe kuponat e fituar mbi investimet me te ardhura fikse si dhe amortizimet e skontove apo primeve mbi bonot e thesarit.

Kur nje kredi behet e dyshimte per t'u arketuar, ajo fshihet kundrejt shumave te rikuperueshme dhe per to nuk njihen me te ardhurat nga interesi.

Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet rrjedhin nga sherbimet financiare te ofruara nga Banka si transferimi i fondeve, aktivite huadhenese, tarifat e mirembajtjes se llogarive dhe komisione te garancive bankare. Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet njihen kur sherbimet perkatese jane kryer.

4.10 Transaksionet spot te kembimit valutor

Banka gjate aktivitetit te saj te zakonshem hyn ne kembime valutore me data likuidimi maksimumi 2 dite pas dates se transaksionit. Keto veprime ne daten e transaksionit regjistrohen si zera jashte bilancit dhe ne daten e likuidimit regjistrohen ne pasqyrat financiare.

Ne daten e gjenerimit te pasqyrave financiare transaksionet spot te veprimeve te kembimit valutor jane rivlersuar dhe rezultati fitim/humbje eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave.

4.11 Zhvleresimi

Vlera kontabel e aktiveve te Bankes rishikohet cdo date bilanci per te percaktuar nese ekziston ndonje evidence zhvleresimi te aktiveve ne fjale. Nese nje indikacion i tille ekziston, atehere percaktohet vlera e rikuperueshme e aktivitet dhe nese kjo vlere eshte me e vogel se vlera kontabel e aktivitet, njihen shpenzimet per zhvleresim te tij dhe regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve te periudhes.

4.12 Qerate

Totali i pagesave te bera per qerate operacionale njihen ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve sipas metodes lineare pergjate jetes se qerases

4.13 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit permban tatimin e vitit aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe do te njiheshin direkt ne kapital.

Tatimi i vitit aktual eshte tatimi qe pritset te paguhet per fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normat e tatimit ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre eshte llogaritur duke perdorur metoden e pozicionit financiar, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat e tatimit qe pritset te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar ne ligjet qe jane ne fuqi ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem, kundrejt te te cilit diferencat e perkohshme te zbritshme apo humbjet e mbartura te mund te perdoren. Tatimi i shtyre rishikohet ne çdo date raportimi dhe zvogelohet deri ne masen qe nuk ka me mundesi qe perfitimi nga tatimi mund te realizohet.

4.14 .Llogarite jashte Bilancit

Ne rrjedhjen normale te biznesit te saj, Banka hyn ne angazhime te lidhura me kredidhenjen, qe regjistrohet si llogari jashte bilancit duke perfshire kryesisht garancite, leter kredite dhe angazhimet per kredite e aprovuara por te pa disbursuara ose te disbursuara pjeserisht. Keto njihen dhe mbahen me vleren e tyre te drejte,

4.15 Aplikimi i standardeve te reja dhe te rishikuara

Banka do te reflektonte ne pasqyrat financiare te meposhtemet:

- Standarde dhe Interpretime te reja apo te rishikuara ne fuqi ne periudhen raportuese;
- Standarde dhe interpretime te reja apo te rishikuara në publikim por qe ende nuk kane hyre ne fuqi;

4.16 Informacioni krahasues

Informacioni krahasues eshte paraqitur ne menyre konsistente duke aplikuar politikat kontabel te Bankes.

5. Gjykimet kontabel dhe burimet kryesore te pasigurise se vleresimeve

Ne aplikimin e politikave kontabel te Bankes te cilat u pershkruan ne seksionin 4 me siper, Drejtimit i eshte kerkuar te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth vlerave te aktiveve dhe pasiveve te cilat nuk jane te gatshme nga burime te tjera. Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara mbi eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe jane konsideruar te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi nese ky rishikim prek vetem ate periudhe, ose periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te pritshme.

Humbjet nga zhvleresimi i huave dhe paradhenieve te klienteve

Banka rishikon portofolin e saj per te vleresuar zhvleresimin te pakten ne baza tremujore. Ne percaktimin nese duhet te rregjistrohet humbje nga zhvleresimi ne pasqyren permbledhese te ardhurave, banka gjykon nese ka te dhena te dukshme te cilat tregojne nje renie ne pagesat e pritshme ne te ardhmen. Kjo deshmi mund te permbaje te dhena te cilat tregojne nje perkeqesim te mundesise per te paguar te disa kredimarresve ne nje grup apo kushtet ekonomike te cilat lidhen me standartet e aktiveve ne grup.

Banka perdor vleresime bazuar ne eksperiencat historike te humbjes te aktiveve me karakteristika te rrezikut dhe evidencave objektive te zhvleresimit te ngjashme me ato te portofolit kur skedulon pagesat e pritshme te tij. Metodologjia dhe supozimet te perdoruara per te vleresuar shumen dhe kohen e pagesave te pritshme, rishikohen rregullisht per te zvogeluar diferencat midis humbjes se vleresuar dhe asaj te ndodhur.

Investime te mbajtura ne maturim

Banka ndjek udhezimet e SNK 39 per te klasifikuar aktivet financiare jo derivative me pagesa fikse dhe maturim te vendosur si “te mbajtura deri ne maturim”. Ky klasifikim kerkon gjykim te konsiderueshem. Ne kryerjen e ketij gjykimi, Banka vlereson qellimin per t’i mbajtur ne maturim keto investime. Nese Banka nuk ia del ne kete qellim per t’i mbajtur keto investime deri ne maturim pervec rasteve specifike-per shembull, shitja e nje pjese te pakonsiderueshme ne prag te maturimit-atehere kerkohet qe e tere kjo kategori te riklasifikohet si “te vlefshme per shitje”. Investimet ne kete rast do te mateshin me metoden e vleres se drejte dhe jo me koston e amortizuar. Vleresimi i vleres se drejte te bonove te thesarit dhe investimeve te mbajtura ne maturim jepet ne noten perkatese ne pasqyrat financiare.

6. Perditësimi i Politikave Kontabile

Banka do të perditësojë politikat kontabile të zbatueshme në bazë të ndryshimeve eventuale të SNRF-se.

7. Formati i Pergatitjes së Pasqyrave Financiare

Banka do të ketë një format standart për pergatitjen e pasqyrave financiare plotësisht në përputhje me SNFR-te. Elementet kryesore janë listuar si më poshtë:

1. Pasqyra e pozicionit financiar
2. Pasqyra përmbledhese e të ardhurave
3. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar
4. Pasqyra e rrjedhës së parase
5. Shenime për pasqyrat financiare